



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 58 Akti

Nr. 79 Vendimi

Tiranë, më 22.11.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Genta Tafa(Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, më datë 21 nëntor 2018, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Enton Dhimitri**, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”);

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shpresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tri kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Enton Dhimitri, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Enton Dhimitri, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, më datë 15.01.2018, në përputhje me “Rregullore për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjyquese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete.

4. Në mbledhjen e trupit gjyques, më datë 18.01.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjyques, komisionere Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyques, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit..

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit

të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

7. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

8. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit z. Enton Dhimitri.*

9. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 09.02.2018.

10. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

11. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 09.11.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

12. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, më datë 12.11.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes, më datë 12.11.2018, dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij, më datë 16.11.2018.

13. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 19.11.2018.

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 21.11.2018, ora 11: 00, në sallën e seancave dëgjimore, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

16. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit, z. Enton Dhimitri, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, në bazë të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;

- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) deklaratimet e personit të lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur;
- e) gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar.

20. Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017, **subjekti i rivlerësimit, deklaroi këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

21. **Automjet, tip “Skoda Octavia Tour”, viti 2011**, blerë sipas faturës tatimore të shitjes nr. ***, datë 10.05.2011, të lëshuar nga “****” sh.p.k., me vlerë 13.900 euro. Në bashkëpronësi me bashkëshorten në pjesë të barabarta.

21.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Kursimet nga paga të subjektit të rivlerësimit në formën e depozitës së kursimit të krijuar, më datë 22.02.2008, në shumën 5.000 euro, e tërhequr më datë 10.05.2011 dhe kredi bankare në shumën 9.000 euro, sipas kontratës së kredisë të lidhur me Bankën Kombëtare të Greqisë, dega Tiranë, më datë 09.05.2011.

21.2 Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 10.05.2011, të automjetit “Skoda Octavia”, në shumën 13.900 euro, në emër të E. dhe Enton Dhimitri, mandatpagesë, më datë 12.05.2011, në shumën 13.900 euro.
- Certifikatë e pronësisë së automjetit, tip “Skoda Octavia”, me targë ***, datë 12.05.2011, në emër të subjektit dhe b/shortes.
- Kredi bankare nga “NBG”, më datë 09.05.2011, në emër të kredimarrësve Enton dhe E. Dhimitri, në shumën 9.000 euro, me afat kohor 12 muaj.
- Marrëveshje siguroese e datës 09.05.2011, midis palëve, “NBG”-së dhe subjektit e b/shortes.
- Vërtetim datë 23.01.2017, konfirmohet kredia e marrë, më datë 09.05.2011, e likuiduar më datë 09.05.2012.

21.3 Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë, nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar Bankës Kombëtare të Greqisë (NBG).
- Shkresë nr. *** prot., datë 04.05.2018, drejtuar shoqërisë “Porsche Albania” sh.p.k.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.06.2018, drejtuar shoqërisë “Porsche Albania” sh.p.k.

Arsyetimi ligjor:

21.4 Për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurive dhe interesave të vitit 2011.

21.5 Sipas akteve shkresore, bashkëlidhur shkresës, nr. *** prot., datë 06.02.2018, të DPSHTRR-së dhe informacioneve nga ana e shoqërisë “Porsche Albania” sh.p.k, rezulton se, me faturën tatimore, nr. ***, datë 06.06.2011, shoqëria “Porsche Albania” sh.p.k., ka shitur automjetin në fjalë kundrejt çmimit 13.827 euro, te shoqëria “****” sh.p.k., e cila, për likuidimin e kësaj fature ka paguar, më datë 17.08.2011, shumën prej 14.500 eurosh, nëpërmjet “Raiffeisen Bank” (sipas shoqërisë “Porsche Albania” sh.p.k., çmimi minimal i aplikuar në shitjen e automjeteve tip “Skoda Octavia” ka qenë 13.827 euro deri në çmimin maksimal 14.555 euro)

21.6 Pas këtij veprimi rezulton se, shoqëria “****” sh.p.k., me faturën tatimore, nr. ***, datë 10.05.2011, ka shitur të njëjtin automjet, kundrejt çmimit 13.900 euro, tek blerësit Enton Dhimitri dhe E. Dh, të cilët, për likuidimin e kësaj fature kanë paguar, më datë 12.05.2011, shumën 13.900 euro, nëpërmjet “NBG”-së. Përpara kryerjes së kësaj pagese, subjekti i rivlerësimit kishte transferuar nga llogaria e tij shumën prej 5.000 eurosh, në llogarinë e bashkëshortes (përshkrimi i transferimit - “xhirim për blerje makine”). Po aty, llogaria e bashkëshortes kreditohet me një *overdraft*, në shumën 9.000 euro, e cila më pas transferohen në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., pranë “NBG”-së, me përshkrimin: për likuidim të faturës nr. ***, datë 10.05.2011.

21.7 Në vijim, rezulton se, më datë 12.05.2011, blerësit kanë paraqitur këtë automjet në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastrë për kontroll fizik dhe teknik dhe, po në këtë datë, janë pajisur me leje qarkullimi dhe certifikatë pronësie në emër të tyre.

21.8 Në lidhje me rishitjen e automjetit për në një shumë, vetëm 73 euro mbi çmimin e blerjes, subjekti i rivlerësimit sqaroi se, bashkëshortja ka lidhje fafaisnore me ortakun e vetëm të shoqërisë “****” sh.p.k., të cilët mundësuan shitblerjen e automjetit me fitim minimal. Për këtë, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit certifikata të trungut familjar, nga të cilat përcaktohet lidhja fafaisnore si më sipër.

21.9 Nga ana tjetër, konstatohet se transaksioni është real sa i takon çmimit, për shkak se ai është brenda vlerave të çmimeve që ka aplikuar shoqëria importuese e tyre “Porsche Albania” sh.p.k., për këtë lloj automjeti (nga 13.827 euro deri në 14.555 euro). Për sa i takon diferencës mes çmimit të faturës së shoqërisë “Porsche Albania” sh.p.k (13.827 euro) dhe pagesës së kryer në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank” (14.500 euro) nga “****” sh.p.k., kjo është çështje që u përket këtyre dy subjekteve tregtare, ku subjekti i rivlerësimit nuk është palë.

21.10 Hetimi i kryer nga Komisioni, u fokusua në të ardhurat që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës prej 13.900 eurosh, shumë e cila është likuiduar, më datë 12.05.2011.

21.11 Nga verifikimi i të dhënave bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur si dhe nga analiza financiare pas verifikimit të të gjitha të ardhurave dhe kursimeve si dhe krahasimin e tyre me deklaratat vjetore të pasurive dhe interesave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit disponon burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e çmimit të faturës së analizuar më sipër. Edhe pas blerjes së këtij aseti, rezulton një balancë fondesh e llogaritur në vlerën plus 976.851 lekë.

21.12 Gjendja financiare pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

<u>Analiza financiare për vitin 2011</u>	
Të ardhurat	2.615.379
Dhurata dhe shpërblim fëmije	300.449
Total të ardhurat	2.915.828
Pagesat për shpenzime	533.349
Ndryshim mjete monetare gj.31.01.2011 - 31.12.2011	-516.059
Mjete monetare të disponueshme (1)	1.866.420
Pagesa për blerje pasurie	1.931.127
Detyrime	1.041.558
Pasuri neto (2)	889.569
Balanca e fondeve (1-2)	976.851

✓ Subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij.

22. Apartament banimi, me sipërfaqe 97 m², i ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastrë, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 05.02.2015, të ZVRPP-së Gjirokastrë, si pasuria nr. ***, ZK ***, në vlerën 4.000.000 lekë, ose ekuivalenti 28.500 euro. Në bashkëpronësi me bashkëshorten në pjesë të barabarta.

22.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Kursimet nga pagat e subjektit në shumën **1.094.340 lekë**, ose ekuivalenti **7.800 euro**, në formën e gjendjes së llogarisë bankare të kursimit për periudhën (31.03.2010 - 14.01.2015), si dhe kursimet e llogarisë së depozitës në euro të bashkëshortes në shumën **20.700 euro**. Blerë me kontratën e shitblerjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.01.2015.

22.2 Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerje, nr. ***, datë 14.01.2015, me palë blerëse Enton Dhimitri dhe E. Dh (G.), të apartamentit me sip. totale 97 m², me nr. pas. ***, ZK ***, në lagjen “****”, Gjirokastrë, me vlerë 4.000.000 lekë ose ekuivalenti në shumën 28.500 euro.
- Vërtetim hipotekor, nr. ***, datë 05.02.2015, në emër të Enton Dhimitri dhe E. Dh (G.). Harta treguese e regjistrimit.

- Transfertë bankare nga “NBG”, datë 14.01.2015, të shumës prej 20.700 eurosh nga llogaria e znj. E. Dh. Transfertë bankare, datë 14.01.2015, të shumës prej 1.094.340 lekësh, nga “NBG” nga llogaria e Enton Dhimitri.
- Deklaratë noteriale e shtetasit G. G, nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 24.12.2015.
- Deklaratë noteriale e shtetasve Th. D dhe E. D nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 13.11.2018.

22.3 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar ZQRPP-së Gjirokastrë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar OSHEE-së.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar bankës “NBG”-së.
- Shkresë nr. *** prot., datë 11.05.2018, drejtuar Bashkisë Gjirokastrë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 11.05.2018, drejtuar ZVRPP-së Gjirokastrë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.06.2018, drejtuar ZVRPP-së Gjirokastrë.

Arsyetimi ligjor:

22.4 Në lidhje me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurive dhe interesave të vitit 2015.

22.5 Nga materialet bashkëlidhur shkresës nr. ***prot., datë 18.05.2018, të Bashkisë Gjirokastrë dhe materialet bashkëlidhur shkresave nr. *** prot., datë 12.02.2018, dhe nr. *** prot., datë 14.05.2018, të Zyrës Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, rezulton që të jenë pasqyruar rregullisht veprimet juridike në lidhje me pallatin ku ndodhet kjo pasuri (mes investitorëve dhe pronarëve të truallit, kontrollat me natyrë teknike e juridike administrative, veçimet e njëjësive si pasuri më vete), që nga leja e sheshit të ndërtimit të pallatit, në vijim me formalitetet e regjistrimit fillestar i tij dhe deri në transaksionin objekt i këtij hetimi administrativ, pra, kontrata e shitblerjes, nr. ***, datë 14.01.2015, mes investitorëve “D” (si palë shitëse dhe si përfaqësues me prokurë të dy bashkëpronarëve të tjera mbi këtë apartament) dhe subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja (si palë blerëse). Në bazë të kësaj kontrate, ZVRPP-ja Gjirokastrë lëshoi vërtetimin e pronësisë, duke konfirmuar shitjen e tij dhe kalimin e pronësisë sipas vetëdeklarimit të subjektit.

22.6 Hetimi i kryer nga Komisioni, u fokusua në shkaqet e përcaktimit të çmimit të asetit (disi më i ulët), në krahasim me vlerën e përafërt të tregut të lirë të zonës së pallatit, si dhe mbi shkakun e mospërfshirjes së sipërfaqeve të përbashkëta në kontratën e shitblerjes.

22.7 Në lidhje me çmimin e kontratës së shitblerjes, subjekti i rivlerësimit argumenton se çmimi i ulët lidhet me faktin se apartamenti nuk ishte i përfunduar tërësisht dhe kishte ende disa punime që duheshin bërë, të cilat i realizoi me ndihmën e kumatit të tij; nga ana tjetër, pala shitëse ishte më e

interesuar në shitjen e apartamentit, sepse ishte në vështirësi financiare dhe kishte nevojë emergjente për likuiditete (subjekti shpjegon se po në të njëjtat kushte është shitur apartamenti ngjitur, madje në një shumë edhe më të ulët).

22.8 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka mbështetur argumentet në deklaratën noteriale të kunatit, shtetasit G. G (nr. ***, datë 24.12.2015), i cili ka kryer punimet, në deklaratën noteriale të shitësve (investitorët dhe njëkohësisht edhe përfaqësues me prokurë të bashkëpronareve të tjera) Th. D dhe E. D (nr. ***, datë 13.11.2018), që konfirmojnë gjendjen fizike të apartamentit në momentin e shitjes, si dhe në kontrata të tjera të shitjeve të apartamenteve të atij pallati (pjesë e fashikullit të akteve të dosjes). Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ky apartament nuk është në përdorim për banim, për shkaqe të arsyeshme të familjes së tij.

22.9 Në lidhje me mungesën e sipërfaqeve të përbashkëta në kontratë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, në kontratën e shitblerjes është disponuar vetëm pasuria e pasqyruar në vërtetimin e pronësisë, në të cilën nuk rezultonin sipërfaqe të përbashkëta.

22.10 Gjithashtu, nga shkresa nr. *** prot., datë 24.07.2018, të ZVRPP-së Gjirokastër dhe materialet bashkëlidhur, Komisioni informohet se, ka mungesë baze ligjore për regjistrimin e sipërfaqeve ndërtimore të pallateve që, sipas nenit 209 germa “a” të Kodit Civil, çmohen bashkëpronësi e detyrueshme dhe, mbi këtë argument, ato nuk pasqyrohen në dokumentacionin e pronësisë së njësive përkatëse. Nga analizimi i dokumentacionit të ZVRPP-së Gjirokastër, mes tyre edhe kontratat e shitblerjeve të njësive të tjera të pallatit, rezulton se, kontratat kanë vlera të përafërta, në respekt të kufijve të çmimeve të referencës të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave (sipas kohës së transaksionit përkatës), sikurse dhe në rastin e kontratës nr. ***, datë 14.01.2015, me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij.

22.11 Në vijim, hetimi i kryer nga Komisioni u fokusua në të ardhurat që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës prej 4.000.000 lekësh, për blerjen e këtij aseti, ose ekuivalenti 28.500 euro, shumë e cila është likuiduar, më datë 14.01.2015.

22.12 Nga verifikimi i të dhënave bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur si dhe nga analiza financiare, pas verifikimit të të gjitha të ardhurave dhe kursimeve si dhe krahasimin e tyre me deklaratat vjetore të pasurive dhe interesave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit disponon burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e çmimit të kontratës së shitblerjes, analizuar si më sipër. Edhe pas blerjes së këtij aseti, rezulton një balancë fondesh e llogaritur në vlerën plus 1.195.394 lekë.

22.13 Gjendja financiare pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Analiza financiare për vitin 2015

Të ardhurat	2.722.675
Pagesat për shpenzime arredime, jetese	2.287.306
Ndryshim mj. monetare gj. 31.01.2015 - 31.12.2015	4.760.025
Mjete monetare të disponueshme (1)	5.195.394
Pagesa për blerje pasurie	4.000.000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	4.000.000
Balanca e fondeve (1-2)	1.195.394

✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat nga dokumentet e administruara.

23. Apartament banimi, me sipërfaqe 74.95 m², në qytetin e Sarandës, Lagja nr. ***, Rr. Nr. ***, i paregjistruar, paguar shuma 32.500 euro nga çmimi total i apartamentit në shumën 38.500 euro, sipas deklaratës noteriale nr. ***, e personit të lidhur me shoqërinë “****”sh.p.k., më datë 28.03.2009. Në zotërim të personit të lidhur: 100 % .

23.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Kursimet nga pagat dhe aksionet e përfituara, periudha tetor 2002 - dhjetor 2012.

23.2 Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.03.2009, midis shoqërisë “****” sh.p.k., me përfaqësues, z. N. Ç, dhe pala blerëse E. G (Dh.), për porositje apartamenti me sip. total 74.95 m², me vlerë 38.500 euro. Në deklaratë është vendosur: Pagesa e parë kryer nga znj. E. G në maj të vitit 2007, shuma 8.000 euro. Pagesa e dytë është në maj të vitit 2008, shuma 10.000 euro. Pagesa e tretë është paguar në muajin mars të vitit 2009, shuma 10.500 euro. Pagesa e mbetur do të paguhej në shumën prej 10.000 eurosh kur të regjistrohej apartamenti.
- Mandatarkëtim, datë 22.10.2010, në shumën 2.000 euro, të kryer nga znj. E. G.
- Transfertë bankare nga “NBG”, datë 07.12.2012, në shumën 2.000 euro.
- Vërtetim nr. ***, datë 05.03.2015, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, për vitet 2004 - 2007, në shumën 3.227.486 lekë.
- Njoftime për pranimin në depozitën e aksioneve të stafit si dhe në planin e vitit 2007 të gjendjes së depozitës së stafit, nga Banka Amerikane e Shqipërisë, më datë 01.12.2009, për aksione në shumën 15.572 USD.
- Nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, më datë 10.03.2010.
- Vërtetim për pagën neto të përfituar nga punëdhënësi “NBG”-ja, për periudhën dhjetor 2007 - 31.12.2016, në shumën 13.097.724 lekë.

23.3 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar ZQRPP-së.

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Ujësjetllës Kanalizime Sarandë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 13.04.2018, drejtuar Ujësjetllës Kanalizime Sarandë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar OSHEE-së.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar “NBG”-së.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë.

Arsyetimi ligjor:

23.4 Personi i lidhur, bashkëshorte e subjektit të rivlerësimit, ka nisur deklarin e saj të parë në deklaratën e pasurive dhe interesave të vitit 2009 pas martesës me subjektin e rivlerësimit.

23.5 Në deklaratën e pasurive dhe interesave të vitit 2009 (deklarim për herë të parë), personi i lidhur ka deklaruar gjendje likuiditetesh:

- Depozitë në “NBG” (kursime nga puna si drejtoare e “NBG”-së dega Gjirokastër, për periudhën 03.12.2007 - 31.12.2009), shuma **5.000 euro**.
- Llogari depozite, pranë “NBG”-së.
- Kursime nga puna tek ish-Banka Amerikane e Shqipërisë, sot “Intesa Sanpaolo Bank” për periudhën 05.04.2004 - 03.12.2007, në shumën **15.258 USD**;
- Të ardhura nga shitja e pjesës së aksioneve si staf i ish-Bankës Amerikane të Shqipërisë, në shumën prej **15.572 USD**, të përfituar, më datë 01.12.2009, në bazë të marrëveshjes së datës 02.06.2005;
- Shuma **30.830 USD**. Pjesa që zotëron: 100 %.

23.6 Burimi i të ardhurave për gjendjen e deklaruar, konfirmohet me shkresën nr. *** prot., datë 11.07.2017, të “Intesa Sanpaolo Bank” dhe materialet bashkëlidhur, sipas të cilave rezulton se personi i lidhur ka pasur llogari page si e punësuar pranë bankës dhe është paguar nga viti 2004 - 2007, konkretisht; në vitin 2004, në vlerën 4.065 USD; në vitin 2005, në vlerën 9.674 USD; në vitin 2006, në vlerën 988.098 lekë; në vitin 2007, në vlerën 864.404 lekë. Totali është në vlerën 13.740 USD dhe 1.852.502 lekë. Gjithashtu konfirmon depozitë në emër të znj. E. G, depozitë në vitin 2004 - 2100 USD; në vitin 2005 - 4500 USD dhe në vitin 2006 - 15.000 USD

23.7 Gjendja e likuiditeteve si më sipër dhe prejardhja e tyre konfirmohet nga shkresa nr. *** prot., datë 02.02.2018, e bankës “NBG” si dhe materialet shoqëruese me të dhënat e llogarive bankare në emër të personit të lidhur.

23.8 Po kështu, në të dhënat konfidenciale të deklaratës së pasurive dhe interesave të vitit 2009, personi i lidhur deklaron:

- Apartament banimi, sipërfaqe 74,95 m², në qytetin e Sarandës, Lagjja: Nr. ***, Rr. ***, i paregjistruar, paguar shuma 28.500 euro, shoqërisë “****” sh.p.k., Sarandë, para se të lidhet kontrata përfundimtare e shitjes. Bashkëlidhur, deklarata noteriale për dhënien e kësaj shumë, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.03.2009, noter B. Xh, Gjirokastrë.

23.9 Në deklaratën noteriale, nr. ***, datë 28.03.2009, është përcaktuar:

- Pagesa e parë është kryer nga znj. E. G në maj të vitit 2007, në shumën 8.000 euro.
- Pagesa e dytë është kryer në maj të vitit 2008, në shumën 10.000 euro.
- Pagesa e tretë është paguar në muajin mars të vitit 2009, në shumën 10.500 euro.
- Pagesa e mbetur në shumën 10.000 euro, do të paguhet kur të regjistrohet apartamenti në ZVRPP-në Sarandë.

23.10 Pra, sipas deklaratës noteriale dhe sipas deklaratës “Vetting” të vitit 2017 (sipas të cilës apartamenti nuk është ende i regjistruar pranë ZVRPP-së Sarandë), pagesa e katërt nuk është bërë ende skadente ose e kërkueshme. Megjithatë, rezultojnë dy pagesa të kryera nga personi i lidhur, të cilat vërtetohen me:

- Mandatarkëtimi nr. ***, datë 22.10.2010 (veprim në sportel në bankën “NBG”-së), në shumën 2.000 euro.
- Transfertë bankare, ref. nr. ***, datë 07.12.2012, nga llogaria personale e personit të lidhur pranë “NBG”-së, në shumën 2.000 euro, me përshkrim të detajeve të pagesës: “pagesë për blerje shtëpie sipas deklaratës”.

23.11 Ekzistenca fizike e asetit konfirmohet nga shkresa, nr. *** prot., datë 16.05.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, si dhe materialet bashkëlidhur, nga të cilat rezulton se, objekti (ku ndodhet apartamenti në fjalë) ka filluar ndërtimin në prill të vitit 2007 dhe ka vazhduar deri, më datë 18.08.2008, sipas lejes së ndërtimit, datë 07.06.2006, me pronar truallisht shtetasen V. Ll, përfundimin e objektit e ka kryer shoqëria “****” sh.p.k., pas verifikimit nuk rezulton që shoqëria “****” sh.p.k., të ketë deklaruar në organin tatimor shitje apartamenti në periudhat e kërkueshme (2007 - 2009).

23.12 Po kështu, mbi këtë aset rezulton informacion nga shkresat nr. *** prot., datë 16.02.2018, dhe nr. *** prot., datë 24.04.2018, të Ujësjetës Kanalizime Sarandë, nga të cilat rezulton se personi i lidhur ka nënshkruar kontratën, nr. **** (pa datë), regjistruar në sistem në vitin 2013, për furnizim me ujë. Kontrata shoqërohet me deklaratën noteriale, nr. ***, datë 28.03.2009, mes saj dhe shoqërisë “****” sh.p.k., që identifikon sendin që furnizohet me ujë.

23.13 Hetimi i kryer nga Komisioni, u fokusua në vërtetësinë e deklaratimit të subjektit të rivlerësimit (pasuria e personit të lidhur), për shkak se, tre pagesat e para (në shumë totale 28.500 euro), ishin bërë përpara celebrimit të martesës së personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, madje edhe

përpara se sa të nënshkruhej deklarata noteriale për porositjen e apartamentit duke dalë i domosdoshëm verifikimi i shkakut të këtyre rrethanave. Po kështu, nga Komisioni u hetua mbi faktin e bashkëjetesës ose jo mes subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur përpara martesës ligjore mes tyre.

23.14 Në kuadër të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe argumentuar faktin ekzistencës së një marrëdhënieje të posaçme mes bashkëshortes së tij dhe shtetasve N. Ç dhe L. Ç (që të dy këta, bashkëshortë). Shtetasja L. (E.) Ç është kumbara e personit të lidhur, fakt që provohet me dokumentin, certifikatë pagëzimi, nr. *** regj.(seria nr. ***), datë 06.06.2007, të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë - Mitropolia e Shenjtë e Gjirokastrës, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka vënë në dispozicion të Komisionit dhe është pjesë e fashikullit të akteve.

23.15 Nisur nga këto rrethana, justifikohet mirëbesimi i personit të lidhur në kryerjen e pagesave përpara nënshkrimit të deklaratës noteriale, nr. ***, datë 28.03.2009.

23.16 Në vijim, hetimi u fokusua edhe mbi dy pagesat e kryera pas lidhjes së martesës, pasi rezulton se janë bërë ndaj një subjekti tregtar në statusin “pezulluar”.

23.17 Nga të dhënat e pasqyruara në regjistrin tregtar (elektronik), rezulton se: me vendimin nr. ***, datë 01.10.2009, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë “Ivani***” sh.p.k., vendos të deklarojë pezullimin e veprimtarisë ndërtimore dhe t’i kërkojë administratës tatimore transferimin në regjistrin e subjekteve pasivë. Më tej, ky vendim është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (sot Qendra Kombëtare e Biznesit), më datë 09.10.2009, datë në të cilën është bërë edhe ndryshimi i statusit, nga “aktiv” në “pasiv” pa afat të përcaktuar. Që nga ky moment, për efekt të legjislacionit tatimor, veprimet e këtij subjekti janë të limituara kryesisht në mbajtje të: regjistrin të protokollit, librave të arkës dhe të bankës, likuidimi i detyrimeve ndaj të punësuarve dhe pushtetit vendor, si dhe në arkëtimin e pagesave për aktivitetin tregtar të periudhës përpara datës 09.10.2009.

23.18 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar dhe argumentuar mbi dy pagesat e fundit në shumën totale 4.000 euro (shuma 2.000 euro, më datë 22.10.2010 dhe shuma 2.000 euro, më datë 07.12.2012), duke pasqyruar rrethanat mbi ecurinë e investimit të shoqërisë “***” sh.p.k., në objektin ku ndodhet aseti, ndarjen e investimit me shoqërinë “***” sh.p.k., dhe shtetasen V. Ll, si dhe gjendjen aktuale teknike e juridike: pallat i përfunduar dhe në shfrytëzim të familjes së tij që nga marrja në dorëzim në periudhën fundi i dhjetorit 2012 - fillimi i janarit 2013 (që është edhe periudhë e formaliteteve me Ujësjellës Kanalizime Sarandë për furnizimin apartamentit me ujë sipas kontratës nr. *** si dhe instalimi i matësit në pikën e lidhjes me apartamentin), si dhe faktin që pallati është në fazën pritjes së regjistrimit në ZVRPP-së Sarandë. Pra, në këto rrethana që zbehin rriskun e vesimit apo të dështimit të marrëdhënies me shoqërinë “***” sh.p.k., si dhe në kuadër të rrethanave të posaçme me bashkëshortët N. Ç dhe L. (E.) Ç, e kanë çmuar të arsyeshme pagimin e dy shumave si më sipër.

23.19 Për të provuar këtë argumentim, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit:

- Kontratën e bashkëpunimit, nr. ***, datë 28.01.2007, mes shoqërisë investitore “****” sh.p.k dhe investitores V. Ll - për ndërtimin dhe mënyrën e pjesëmarrjes në këtë investim (ndërtimi i objektit në bazë të vendimit të KRRT-së, Bashkia Sarandë si dhe lejes së ndërtimit, nr. ***, datë 07.10.2006).
- Kontratë nr. ***, datë 18.08.2008, mes shoqërisë “****” sh.p.k, znj. V. Ll, z. A. N dhe z. A. N (këta të dy ortakë të shoqërisë “****” sh.p.k) – për zgjerimin e bashkëpunimit dhe ndarjen e pjesëve në investim.
- Deklaratë noteriale, nr. ***, datë 14.10.2008, mes shoqërisë “****” sh.p.k dhe shoqërisë “****” sh.p.k, nëpërmjet të cilës, shoqëria “****”sh.p.k., i kalon të drejtat dhe detyrimet e saj mbi investimin në favor të shoqërisë “****” sh.p.k (duke mbajtur disa nga njësitë e objektit).
- Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, nëpërmjet të cilës vërtetohet se janë likuiduar detyrimet tatimore të objektit në fjalë, lëshuar për efekt të regjistrimit të tij në ZVRPP-në Sarandë.

23.20 Dokumentacioni i mësipërm është pjesë e fashikullit të akteve të dosjes dhe në bazë të tyre justifikohen pagesat e datës 22.10.2010 (në shumën 2.000 euro) dhe më datë 07.12.2012 (në shumën 2.000 euro), pavarësisht se në këto periudha shoqëria “****” sh.p.k., kishte vendosur pezullim të aktivitetit tregtar në bazë të vendimit.

23.21 Hetimi i Komisionit u fokusua mbi bashkëjetesën ose jo mes subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur përpara martesës ligjore mes tyre, në kuptim të nenit 163 të Kodit të Familjes, nisur nga gjetja e disa udhëtimeve të përbashkëta jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (në të njëjtën datë, nga e njëjta pikë e kalimit kufitar dhe me të njëjtin mjet udhëtimi), përpara datës 14.09.2009 (data e celebrimit të martesës).

23.22 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe argumentuar se, mes tij dhe personit të lidhur nuk ka ekzistuar asnjëherë bashkëjetesë dhe ata nuk janë gjendur në asnjë rrethanë bashkëjetese sipas përcaktimeve të nenit 163 të Kodit të Familjes. Mbi daljet e përbashkëta subjekti i rivlerësimit argumenton se ato kanë qenë në funksion të forcimit të njohjes dhe përgatitjes për një jetesë të përbashkët, në martesë ligjore, në respekt të traditës familjare të secilit dhe të besimit fetar të familjes së personit të lidhur.

23.23 Nisur nga ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, në trajtimin e bashkëjetesës, Komisioni mban në konsideratë elementët e saj, në analizë të nenit 163 të Kodit të Familjes:

- Të dy partnerët të kenë vendosur për një banesë të përbashkët, që e përdorin si vendqëndrim me karakter të përhershëm;

- Qëndrimi në banesë të përbashkët të jetë në funksion të krijimit të një strehe të qetë dhe intime, me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave të çiftit, pra të mos jetë një rrethanë e rastësishme apo e krijuar për të ndarë shpenzimet e përditshme në ngarkim të secilit prej tyre;
- Qëndrimi në banesën e përbashkët të ketë karakter real dhe të vazhdueshëm dhe të mos ketë si qëllim simulimin apo dhënien e imazhit të rremë;
- Qëndrimi në bashkëjetesë të jetë i deklaruar apo i pranuar nga të dy partnerët.

23.24 Konstatimet e Komisionit se subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer udhëtime jashtë shtetit qëndrojnë (i pranon edhe subjekti i rivlerësimit), por këto periudha të shkurtra qëndrimi jashtë shtetit nuk mund të çmohen si rrethanë bashkëjetese, pasi nuk plotësohet kushti i qëndrimit në një adresë të përbashkët, të deklaruar si vendqëndrim me karakter të përhershëm.

23.25 Mungesa e bashkëjetesës rezulton edhe nga deklarimi i prerë mohues i subjektit të rivlerësimit, nga i cili nuk pranohet bashkëjetesa, si dhe nga mungesa e një deklarate ku të shprehet në mënyrë eksplicite jetesa e përbashkët si familje (nuk plotësohet një nga elementët e saj të domosdoshëm për ta çmuar si të qenësishme: vullneti i përbashkët dhe i shprehur qartë për të jetuar bashkë).

23.26 Në këtë kuptim, disponimi i të ardhurave të personit të lidhur në periudhën përpara celebrimit të martesës, përbën ushtrim të së drejtës së disponimit të pasurisë së saj vetjake.

23.27 Sipas analizës financiare, bazuar në shkresat e bankave mbi pagat dhe depozitat, rezulton se personi i lidhur ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të kryer pagesat e mësipërme për apartamentin në fjalë, në shumën totale 28.500 euro në vitin 2009, vit në të cilin rezulton një balancë fondesh e llogaritur, në vlerën plus 311.358 lekë.

23.28 Gjithashtu, në analizën financiare të vitit 2010 dhe vitit 2012 të familjes Dhimitri, rezulton se ata kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesat përkatëse me nga 2.000 euro në secilin vit (sipas veprimeve pranë “NBG”së), ku rezultojnë me balancë fondesh e llogaritur në vlerën plus 676.018 lekë (viti 2010) dhe në vlerën plus 964.908 lekë (për vitin 2012).

23.29 Gjendja financiare pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Analiza financiare për vitin 2009 p. i lidhur (14.09.2009 - 31.12.2009)

Të ardhurat, paga neto dhe interesa	1.597.364
Të ardhura nga shitja e aksioneve bashkëshortja	1.492.040
Total të ardhurat	3.089.404
Pagesat për shpenzime, qira të subjektit të rivlerësimit	114.000
Pagesat për shpenzime jetese	206.667

Total shpenzime	320.667
Ndryshim mj. monetare gj. 31.01.2011 -3 1.12.2011	-2457379
Mjete monetare të disponueshme (1)	311.358

Analiza financiare për vitin	2010	2012
Të ardhurat	2.443.352	3.020.000
Pagesat për këst apartamenti 2000 euro	277.540	279.180
Pagese kredie, te tjera		1.070.220
Pagesat për shpenzime jetese	480.000	480.000
Total shpenzime	757.540	1.829.400
Ndryshim mj. monetare fillim-fund periudhe	-1.009.794	-225.692
Mjete monetare të disponueshme	676.018	964.908

✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat nga dokumentet e administruara. Personi i lidhur ka pasur burime të mjaftueshme për të justifikuar pagesat në lidhje me këtë apartament.

24. Truall, me sipërfaqe 440 m², mbi të cilën ngrihet **shtëpi banimi**, me sipërfaqe 171.5 m², e ndodhur në lagjen “****”, të qytetit Gjirokastrë, e pasqyruar në vërtetimin hipotekor, nr. ***, datë 18.10.2012, të ZVRPP-së Gjirokastrë, si pasuria nr. ***, ZK ***. Në zotërim të personit të lidhur: 25 %.

24.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: E fituar me trashëgimi nga babai sipas vendimit nr. ***, datë 18.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në bashkëpronësi me nënën dhe dy vëllezërit, me nga ¼ pjesë takuese ideale secili.

24.2 Në lidhje me këtë, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim hipotekor, nr. ***, datë 18.10.2012, në emër të znj. E. Dh (G.) ku zotëron ¼ pjesë të truallit me sip. 440 m² dhe sip. banimi 171.5 m², të shtëpisë së banimit në lagjen “****”, Gjirokastrë.
- Harta treguese e regjistrimit. Vërtetim nr. ***, datë 13.12.2000, në emër të z. P. G + harta treguese.
- Kontratë e pjesëtimit vullnetar, nr. ***, datë 06.12.1974, midis vëllezërve S. G, P. G dhe K. G, ku P. G përfiton një katoq, një dhomë, korridor, e tualet në katin e parë si dhe 2 dhoma, korridor dhe verandë në katin e dytë.
- Vendim gjykate, nr. ***, datë 18.09.2012, në lidhje me dëshminë e trashëgimisë ligjore, e cila përcaktoi ndarjen me ¼ e pasurisë ndërmjet 4 pjesëtareve të mbetur të familjes, pas vdekjes së babait të personit të lidhur.

24.3 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.
- ILDKPKI-ja ka përcjellë pranë Komisionit shkresën, nr. *** prot., datë 12.12.2017, të ZVRPP-së Gjirokastrë.

Arsyetimi ligjor:

24.4 Personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën e pasurive dhe interesave të vitit 2012 bashkëpronësinë me 1/4 pjesë mbi një banesë 2-katëshe me oborr, me sipërfaqe ndërtimore 171.5 m² dhe truall me sipërfaqe 440 m² në lagjen “****”, Gjirokastrë, përfituar si trashëgimi nga babai i saj, sipas trashëgimisë ligjore në bazë të vendimit, nr. ***, datë 18.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i cili mori formë të prerë, më datë 03.10.2012.

24.5 Nga të dhënat e ZVRPP-së Gjirokastrë, rezulton se vendimi gjyqësor i dëshmisë së trashëgimisë ligjore është regjistruar, më datë 18.10.2012, dhe në bazë të regjistrimit hipotekor, nr. ***, datë 18.10.2012, pasuria ka kaluar në emër të trashëgimtarëve: A. G, L. G, G. G dhe E. Dh (Gushi) me nga ¼ pjesë secili.

24.6 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë si vendbanim i dytë i subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave” të vitit 2009, pra në vitin e martesës së tij me personin e lidhur. Ndërsa si pasuri në bashkëpronësi, personi i lidhur, e ka deklaruar në “Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave” për vitin 2012, në të njëjtin vit që është regjistruar dëshmia e trashëgimisë ligjore. Kjo pasuri nuk rezulton të ketë pësuar ndryshime që i nënshtrohen procedurave të legalizimit.

✓ Personi i lidhur ka qenë i saktë në deklarin e tij.

25.1 Sende të luajtshme për rregullim dhe mobilim, si dhe pajisje elektroshtëpiake për apartamentin e banimit në qytetin e Gjirokastrës, në vlerën 1.885.476 lekë. Në bashkëpronësi me bashkëshorten në pjesë të barabarta.

25.1.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Kursimet nga paga e vitit 2015 dhe 2016, të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes, si dhe kursimet e tërhequra nga depozitat në lekë dhe në euro të bashkëshortes.

25.2 Mobilim i apartamentit të banimit, në qytetin e Sarandës, likuiduar faturë tatimore, nr. ***, datë 02.09.2016, subjektit juridik “****” sh.p.k., në vlerën 360.607 lekë. Në zotërim të personit të lidhur: 100 % .

25.2.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Pakësimi i depozitës në euro për vlerën 3.000 euro në vitin 2016.

25.3 Në lidhje me këto, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 01.09.2015, në shumën 1.120.000 lekë, midis shitësit “****” sh.a. dhe blerës znj. E. Dh. Shoqëruar me fletëdalje, nr. ***, datë 01.09.2015.

- Faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 28.12.2015, në shumën 87.906 lekë, midis shitësit “****” sh.a., blerës E. Dh (shoqëruar me kupon tatimor pagese *cash*).
- Faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 22.03.2016, në shumën 73.180 lekë, midis shitësit “****” sh.a. dhe blerës E. Dh (shoqëruar me kupon tatimor pagese *cash*).
- Faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 07.10.2015, në shumën 37.643 lekë, midis shitësit “****” sh.p.k. dhe blerës Enton Dhimitri (shoqëruar me kupon tatimor pagese *cash*).
- Faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 06.10.2015, në shumën 32.064 lekë, midis shitësit “****” sh.p.k dhe blerës Enton Dhimitri (shoqëruar me kupon tatimor pagese *cash*).
- Faturë tatimore, nr. ***, datë 26.10.2015, në shumën 94.683 lekë, midis shitësit “****” sh.p.k dhe blerës Enton Dhimitri.
- Faturë e thjeshtë tatimore, nr. ***, datë 26.12.2015, midis shitësit A. Sh dhe blerës Enton Dhimitri, në shumën 150.000 lekë.
- Faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 17.09.2015, midis shitësit “****” sh.p.k dhe blerës E. Dh, në shumën 115.000 lekë (shoqëruar me kupon tatimor pagese *cash*).
- Faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 21.12.2016, midis shitësit A. Sh dhe blerës E. Dh, në shumën 175.000 lekë (shoqëruar me dy kuponë tatimorë pagese *cash*).

25.4 Dokumentacioni i mësipërm rezulton të jetë i noterizuar “fotokopja e njëjtë me origjinalin”, më datë 04.01.2017.

25.5 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar “NBG”-së.

Arsyetimi ligjor:

25.6 Mbi mobilimin e apartamentit të blerë në qytetin e Gjirokastrës, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar në deklaratën e pasurive dhe interesave të vitit 2015 dhe të vitit 2016.

25.7 Në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar:

- Sende të luajtshme për arredim shtëpie të blera tek kompania “****” sh.a., në vlerë 1.120.000 lekë, në pjesë takuese: 50 % me bashkëshorten.
- Shtuar pajisje elektroshtëpiake, në vlerë 285.532 lekë, në pjesë takuese: 50 % me bashkëshorten.
- Shtuar mallra të tjerë për rregullim dhe kompletim apartamenti në vlerë 202.906 lekë, në pjesë takuese: 50% me bashkëshorten.
- Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtyre pasurive të luajtshme subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
- Pakësuar shuma e kursyer gjatë vitit 2015 për blerje elektroshtëpiake, në vlerë 285.532 lekë (në këtë vit subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar shumë të kursyer në llogari kursimi pranë

“NBG”-së, për vitin 2015, shumën 300.000 lekë). Të ardhurat e deklaruara në këtë vit për deklaruesin janë nga paga në vlerë 1.238.746 lekë dhe nga udhëtime dhe dieta në vlerë 102.000 lekë.

25.7.1 Po këtë vit, personi i lidhur ka deklaruar:

- Shtuar kursimet në lekë nga paga dhe shpërblimet e marra gjatë vitit 2015 në llogari depozite në lekë, në vlerë 193.000 lekë;
- Pakësuar depozita në lekë, gjendje, më datë 31.12.2014, shuma 500.000 lekë;
- Pakësuar në vlerën 3.036 euro nga llogaria e depozitës në euro, ekuivalenti 427.000 lekë;
- Pakësuar kursimet në lekë të vitit 2015, shuma 193.000 lekë;
- Gjithsej në vlerë 1.120.000 lekë, për arredim shtëpie te shoqëria “****” sh.a.

25.7.2 Pakësuar kursimet në llogarinë e pagës, gjatë vitit 2015 për blerje mallra për rregullim dhe kompletim apartamenti në vlerë 202.906 lekë.

25.7.3 Të ardhurat e personit të lidhur në këtë vit burojnë nga paga dhe shpërblimet si drejtuese rajonale e marrëdhënieve me biznesin e vogël, pranë “NBG”-së, degët Gjirokastrë, Sarandë, në vlerë 1.366.964 lekë , si dhe nga pagesat për udhëtime e dieta gjatë vitit 2015, në vlerë 4.000 lekë.

25.7.4 Referuar të dhënave nga “NBG”-ja, rezulton se, më datë 31.12.2014, llogaria depozitë në lekë ka një gjendje 500.441,56 lekë . Më datë 20.05.2015, me transfertë janë këmbyer në lekë 3.036 euro, dhe më datë 20.05.2015, është transferuar shuma prej 1.120.000 lekësh nga kjo llogari për shoqërinë “****” sh.a, me përshkrimin “likuidim fature nr. 282, datë 19.05.2015, për arredim shtëpie E. Dh”

25.8 Në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Shpenzime për arredim shtëpie të ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastrë, nga kursimet nga paga për vitin 2016 (të tij dhe personit të lidhur), në vlerë 248.180.4 lekë.

25.8.1 Të ardhurat e deklaruara në këtë vit për deklaruesin janë nga paga në vlerë 1.227.103 lekë dhe nga udhëtime dhe dieta në vlerë 58.000 lekë.

25.8.2 Po këtë vit, personi i lidhur ka deklaruar:

- Shpenzime për arredim shtëpie të ndodhur në qytetin e Sarandës, në vlerë 360.607 lekë, nga shuma 3.000 euro, e tërhequr nga llogaria e depozitës në euro.

25.8.3 Të ardhurat e personit të lidhur në këtë vit janë nga paga pranë “NBG”-së, në vlerë 1.383.426 lekë, si dhe nga dieta në vlerë 4.600 lekë. Shuma 360.607 lekë në deklaratën “Vetting” rezulton të jetë pasqyruar në “Deklaratën e Pasurisë së Personit të Lidhur”.

25.8.4 Nga analiza e treguesve financiarë të familjes Dhimitri për vitin 2016, referuar të dhënave të deklaruara si dhe informacionit të disponueshëm mbi pagat dhe gjendjen bankare, rezulton një balancë fondesh e llogaritur në vlerën plus 1.872.236 lekë. Subjekti rivlerësimi dhe personi i lidhur disponojnë të ardhura të mjaftueshme për të realizuar mobilimin dhe arrendimin e apartamenteve në këtë vit.

25.8.5 Gjendja financiare pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Analiza financiare për vitin 2016

Të ardhurat	2.683.118
Pagesat për shpenzime arredime, mobilim	608.787
Pagesat për shpenzime jetese	640.000
Total shpenzime	1.248.787
Ndryshim mj. monetare gj.01.01.2016 - 31.12.2016	437.905
Mjete monetare të disponueshme	1.872.236

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat nga dokumentet e administruara dhe analizën financiare. Subjekti i rivlerësimi dhe personi i lidhur disponojnë burime të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë e analizuar më sipër.

26.1 Gjendja në llogarinë e pagës në lekë pranë “NBG”-së, më datë 23.01.2017, në shumën 20.371 lekë. Subjekti i rivlerësimi zotëron: 100 %.

26.1.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Të ardhurat nga paga e vitit 2016.

26.2 Gjendja në llogarinë e kursimit në lekë pranë “NBG”-së, më datë 23.1.2017, në vlerën 6.104.36 lekë. Subjekti i rivlerësimi zotëron: 100 %.

26.2.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Të ardhurat nga paga në vite.

26.3 Në lidhje me këto, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim, datë 23.01.2017, nga “NBG”-ja, konfirmon gjendjen e llogarisë së pagës në shumën 20.371 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 24.01.2017, nga Shkolla e Magjistraturës, mbi të ardhurat nga bursa (2002 - 2004).

- Vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, mbi të ardhurat nga paga (2004 - 2005).
- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, mbi të ardhurat nga paga (2005 - 2014).
- Vërtetim nr. *** prot., datë 19.01.2017, nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, mbi të ardhurat nga paga (2014 - 2016).

26.4 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar “NBG”-së.

Arsyetimi ligjor:

26.5 Mbi llogaritë bankare pranë “NBG”-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurive dhe interesave të vitit 2010 (mbi gjendjen në llogarinë e kursimit) dhe të vitit 2015 (mbi gjendjen në llogarinë e pagës).

26.6 “NBG”-ja ka kthyer përgjigje me shkresat: nr. *** prot., datë 02.02.2018, nr. *** prot., datë 08.05.2018, nr. *** prot., datë 06.06.2018, shoqëruar me dokumentacionin e plotë të veprimeve dhe gjendjes bankare të subjektit të rivlerësimit. Nga informacioni i kësaj banke rezulton se subjekti i rivlerësimit ka çelur llogari kursimi në lekë, më datë 29.03.2010, dhe llogari page në lekë, më datë 02.12.2015.

26.7 Nga analiza e materialeve bankare si më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, më datë 23.01.2017, disponon vlerën 20.371 lekë në llogarinë e pagës dhe vlerën 6.104.36 lekë në llogarinë e kursimit.

26.8 Të ardhurat nga vërtetimet e mësipërme të lëshuara nga institucionet e punës së subjektit të rivlerësimit, në konsideratë të analizave financiare të mësipërme, janë të mjaftueshme për krijimin e gjendjeve në lekë.

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “NBG”-ja.

27. Gjendja e llogarisë së kursimit për fëmijë, për djalin Xh. Dh, më datë 23.01.2017, në vlerën 675.671,57 lekë. Zotëron: 100 %.

27.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Dhurata nga familjarët për lindjen e djalit, shpërblim për lindje nga punëdhënësi i personit të lidhur, “NBG”-së, kursimet nga pagat e personit të lidhur, derdhjet nga gjyshja (vjehrra e subjektit të rivlerësimit) në llogari kursimi dhe interesat bankare të kësaj llogarie kursimi për fëmijë për periudhën 2011 - 23.01.2017.

27.2 Subjekti vë në dispozicion:

- Vërtetim nr. ***, datë 23.01.2017, nga “NBG”-ja, e cila konfirmon gjendjen e llogarisë së kursimit në shumën 675.671,57 lekë.
- Vërtetim për pagën neto të përfituar nga punëdhënësi, “NBG”-ja, për periudhën dhjetor 2007 - 31.12.2016, në shumën 13.097.724 lekë.

27.3 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar “NBG”-së.

Arsyetimi ligjor:

27.4 Mbi depozitën e të birit të subjektit të rivlerësimit është deklaruar në deklaratën e pasurive dhe të interesave të vitit 2011, në shumën fillestare 300.449 lekë, me burim: Dhurata nga familjarët për lindjen e djalit dhe 10.000 lekë nga punëdhënësi i personit të lidhur (“NBG”).

27.5 Në kuadër të hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shumata e dhuruara në formë urimi nga familjarët, me rastin e lindjes së të birit nuk e kalonin shumën 500 euro. Kjo llogari është shtuar me kontribute të personit të lidhur dhe të vjehrrës së tij si dhe nga interesat që krijonte kjo llogari.

27.6 “NBG”-ja ka kthyer përgjigje me shkresat: nr. *** prot., datë 02.02.2018, nr. *** prot., datë 08.05.2018, nr. *** prot., datë 06.06.2018, shoqëruar me dokumentacionin e plotë të veprimeve dhe gjendjes bankare të djalit të subjektit të rivlerësimit. Nga pasqyra e lëvizjeve në këtë llogari bankare konfirmohet fakti i çeljes së depozitës në shumën 300.449 lekë si dhe i shtimit të saj me kontributet të herë pas herëshme në shumata të vogla nga personi i lidhur dhe gjyshja e të miturit.

27.7 Nga analiza e materialeve bankare si më sipër, rezulton se në llogarinë e kursimit për fëmijë, më datë 23.01.2017, është gjendja 675.671,57 lekë.

27.8 Të ardhurat nga vërtetimet e mësipërme të lëshuara nga institucionet e punës së personit të lidhur, në konsideratë të analizave financiare të mësipërme, janë të mjaftueshme për krijimin e gjendjes së llogarisë së kursimit për fëmijë në lekë.

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “NBG”-ja.
- ✓ Përputhen deklaramet e subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

28. Gjendja e llogarisë së kursimit për fëmijë, për djalin M. Dh., më datë 23.01.2017, në vlerën 205.406,73 lekë. Zotëron: 100 %.

28.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Dhurata nga familjarët për lindjen e djalit dhe interesat bankare të kësaj llogarie kursimi për fëmijë për periudhën 2015 - 23.01.2017.

28.2 Subjekti vë në dispozicion:

- Vërtetim nr. ***, datë 23.01.2017, nga “NBG”-ja, e cila konfirmon gjendjen e llogarisë së kursimit në shumën 205.406,73 lekë.

28.3 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar “NBG”-së.

Arsyetimi ligjor:

28.4 Mbi depozitën e të birit të subjektit të rivlerësimit është deklaruar në deklaratën e pasurive dhe të interesave të vitit 2015, në shumën fillestare 200.000 lekë, me burim: Nga urimet e familjareve me rastin e lindjes së djalit në një periudhë 2-vjeçare.

28.5 Në kuadër të hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shumata e dhuruara në formë urimi nga familjarët, me rastin e lindjes së të birit nuk e kalonin shumën 500 euro. Kjo llogari është shtuar nga interesat që krijonte kjo llogari.

28.6 “NBG”-ja ka konfirmuar faktin e çeljes së depozitës në shumën 200.000 lekë, më datë 26.05.2015, si dhe i shtimit të saj me interesat bankare.

28.7 Nga analiza e materialeve bankare si më sipër, rezulton se në llogarinë e kursimit për fëmijë, më datë 23.01.2017, është gjendja në vlerën 205.406,73 lekë.

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “NBG”-ja.

29. Në emër të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, znj. E. Dh (G.), subjekti ka deklaruar:

29.1 Gjendja në llogarinë e depozitës në euro pranë “NBG”-së, më datë 23.01.2017, në vlerën 21.000.53 euro. Personi i lidhur zotëron: 100 %.

29.1.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Paga në vite dhe interesat e depozitave në lekë, euro dhe dollarë në vite.

29.2 Gjendja në llogarinë e depozitës në lekë pranë “NBG”-së, më datë 23.01.2017, në vlerën 4.56 lekë. Personi i lidhur zotëron: 100 %.

29.2.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Pagat në vite.

29.3 Gjendja në llogarinë e depozitës në dollarë, pranë “NBG”-së, më datë 23.01.2017, në vlerën 0.83 USD. Personi i lidhur zotëron: 100 %.

29.3.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Pagat në vite.

29.4 Gjendja në llogarinë e pagës në lekë pranë “NBG”-së, më datë 23.01.2017, në vlerën 54.06 lekë. Personi i lidhur zotëron: 100 %.

29.4.1 Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Pagat në vite.

29.5 Subjekti vë në dispozicion:

- Vërtetim nr. ***, datë 23.01.2017, nga “NBG”-ja, e cila konfirmon gjendjen e llogarisë së kursimit në shumën 205.406,73 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë, periudha 15.10.2002 - 08.04.2004.
- Vërtetim, datë 05.03.2015, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, mbi të ardhurat nga paga në periudhën 2004 - 2007.
- Vërtetim nr. extra prot., datë 02.03.2015 nga Kolegji Universitar “LOGOS” për punën si pedagogë në periudhën 2003 - 2008.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 22.05.2007, nga Instituti i Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, Gjirokastrë, për punën si pedagogë në periudhën 2003 - 2004 dhe në vazhdim (viti 2007), shoqëruar me borderonë e pedagogëve, maj 2007.
- Regjistri i punëmarrësve të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Gjirokastrë, me të ardhurat e punëmarrëses E. Dh, për periudhën 2007 - 2016.
- Marrëveshje “Depozita me afat e këmbyeshme”, nr. ***, datë 31.08.2012, shoqëruar me shtojcën nr. *** dhe shtojcën nr. ***.

29.6 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.04.2018, drejtuar “NBG”-së.
- Shkresë nr. *** prot., datë 01.06.2018, drejtuar “Intesa Sanpaolo Bank”.
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Arsyetimi ligjor:

29.7 Nga ILDKPKI-ja rezulton shkresa, nr. *** prot., datë 11.07.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank” dhe materialet bashkëlidhur, sipas të cilave rezulton se personi i lidhur ka pasur llogari page si e punësuar pranë bankës dhe është paguar nga viti 2004 - 2007, konkretisht: viti 2004, në vlerën 4.065 USD; viti 2005, në vlerën 9.674 USD; viti 2006, në vlerën 988.098 lekë; viti 2007, në vlerën 864.404 lekë. Totali është në vlerën 13.740 USD dhe 1.852.502 lekë. Gjithashtu kjo bankë konfirmon depozitë në emër të znj. E. G, depozitë në vitin 2004 - 2100 USD; viti 2005 - 4500 USD dhe viti 2006 - 15.000 USD. Të dhënat e këtij materiali konfirmohen nga kjo bankë edhe në dy shkresat e saj drejtuar Komisionit: shkresa nr. *** prot., datë 02.02.2018 dhe shkresa nr. *** prot., datë 13.06.2018, si dhe pasqyrat e detajuara të veprimeve të personit të lidhur me këtë bankë.

29.8 Me fillimin e marrëdhënieve të punës së personit të lidhur pranë “NBG”-së, pagat e saj si pedagoge si dhe fondet e saj (kursime nga pagat dhe interesat e depozitave dhe nga aksionet) transferohen nga “Intesa Sanpaolo Bank”, pranë “NBG”-së, duke vijuar trajtimin nga kjo e fundit në kushtet preferenciale të bankës për nëpunësit e saj, si kompensim për kufizimet në marrëdhëniet e drejtuesve të një banke të nivelit të dytë me bankat e tjera konkurrencte, të diktuar nga legjislacioni bankar në Shqipëri. Këtë regjim të trajtimit të personit të lidhur, e ka shpjeguar dhe argumentuar edhe subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

29.9 Gjendja e likuiditeteve si më sipër dhe prejardhja e tyre konfirmohet nga shkresa, nr. *** prot., datë 02.02.2018, e bankës “NBG”, si dhe materialet shoqëruese me të dhënat e llogarive bankare në emër të personit të lidhur. “NBG”-ja ka kthyer përgjigje me shkresat: nr. *** prot., datë 08.05.2018 dhe nr. *** prot., datë 06.06.2018, shoqëruar me dokumentacionin e plotë të veprimeve dhe gjendjes bankare të personit të lidhur, nga të cilat konfirmohet gjendja e balancës së arritur deri në datën e deklaratës “Vetting”.

29.10 Si përfundim, me vërtetimin nr. **, datë 23.01.2017, “NBG” vërteton se personi i lidhur, nëpunëse drejtuese e degës së kësaj banke në Gjirokastrë, ka këto gjendje në llogaritë e saj:

Llogari depozite në euro - 21.000,3 euro;

Llogari depozite në lekë -4,56 lekë;

Llogari depozite në dollarë – 0,83 USD;

Llogari page në lekë - 54,06 lekë.

✓ Përputhet deklarimi i personit të lidhur me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “NBG”-ja.

30. TË ARDHURAT E SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT:

- Të ardhurat nga bursat si kandidat për magjistratë, nga Shkolla e Magjistraturës Tiranë, (periudha tetor 2002 - 16.09.2004), në vlerën **772.790 lekë**.

- Të ardhura nga paga, dieta dhe orë jashtë orarit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, (periudha 17.09.2004 - 30.09.2005), në vlerën **812.724 lekë**.
- Të ardhura nga paga, fondi i veçantë dhe orë jashtë orarit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, (periudha 03.10.2005 - 13.03.2014), në vlerën **7.466.527 lekë**.
- Të ardhura nga paga, dieta, Gjykata e Apelit Gjirokastrë (periudha 13.03.2014 - 31.12.2016), në vlerën **3.694.853 lekë**.
- Interesa bankare nga depozita në euro, pranë “NBG”-së (periudha 2008 - 2011), në vlerën **683 euro**.
- Interesa bankare nga llogaria e kursimit në lekë, pranë “NBG”-së (periudha 2010 - 2016) në vlerën **41.305 lekë**.
- Totali i të ardhurave në vlerën **12.788.199 lekë** dhe **683 euro**.

30.1 Subjekti vë në dispozicion:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 24.01.2017, nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën nga viti 2002 - 2004, bursë në shumën **772.790 lekë**.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2016, nga Gjykata e Shkallës së Parë Kurbin, për periudhën nga 17.09.2004 deri në 30.09.2005, në shumën **812.724 lekë**.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë, për periudhën nga 03.10.2005 deri në 31.03.2014, në shumën **7.466.527 lekë**.
- Noterizuar dokument nr. *** rep., datë 04.01.2017 .
- Vërtetim nr. *** prot., datë 19.01.2017, nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, për periudhën nga 13.03.2014 - 31.12.2016, në shumën **3.694.853 lekë**.

Hetimi i Komisionit:

30.2 Verifikimi i të ardhurave është trajtuar në të gjitha transaksionet e mësipërme, mbështetur në të dhënat e konfirmuara nga institucionet ku ka ushtruar detyrën si dhe nga bankat.

- ✓ Të ardhurat e deklaruara nga subjekti përputhen me dokumentacionin e dorëzuar në vlerën totale prej rreth 12.747.000 lekësh.

31. DETYRIME FINANCIARE

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrime financiare.

32. TË ARDHURAT E PERSONIT TË LIDHUR:

- Të ardhurat nga paga, Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë (periudha 15.10.2002 - 08.04.2004), në vlerën **351.710 lekë**.

- Të ardhurat nga paga, Kolegji Universitar “LOGOS” (periudha tetor 2003 - prill 2008), në vlerën **300.000 lekë**.
- Të ardhurat nga paga, Banka Amerikane e Shqipërisë, sot “Intesa Sanpaolo Bank” (periudha 08.04.2004 - 03.12.2007), në vlerën **3.227.486 lekë**.
- Të ardhurat të përfituara nga shpërndarja e aksioneve të Bankës Amerikane të Shqipërisë, të marrë, më datë 02.12.2009, në bazë të marrëveshjes së datës 21.06.2005, në vlerën **15.572,9 USD**.
- Të ardhurat nga paga, dietat, shpërblime dhe leje lindje, Banka Kombëtare e Greqisë, dega Tiranë, sot “NBG” (periudha 03.12.2007 - 31.12.2016), në vlerën **13.988.588 lekë**.
- Interesa bankare nga depozita në lekë pranë “NBG”-së (periudha 2008 - 2013), në vlerën **95.834 lekë**.
- Interesa bankare nga depozita në euro pranë “NBG”-së (periudha 2009 - 2016), në vlerën **3.281.82 euro**.
- Interesa bankare nga depozita dhe llogaria e kursimit në dollarë pranë “NBG”-së (periudha 2009 - 2014), në vlerën **519.31 dollarë**.
- Totali **17.963.618 lekë; 3.281,82 euro; 16.092,21 USD**.

32.1 Personi i lidhur vë në dispozicion:

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto nga DRSSH-së Gjirokastrë, për periudhën 15.10.2002 - 08.04.2004, në shumën **351.710 lekë**.
- Vërtetim nr. ***, datë 05.03.2015, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, për vitet 2004 - 2007, në shumën **3.227.486 lekë**.
- Vërtetim për pagën neto të përfituar nga punëdhënësi Banka Kombëtare e Greqisë, për periudhën dhjetor 2007 - 31.12.2016, në shumën **13.097.724 lekë**.
- Vërtetim nr. extra prot, datë 02.03.2015, nga Kolegji Universitar “LOGOS”, nga tetori 2003 deri në prill 2008 (pa vlerë vërtetimi).
- Nxjerrje llogarie bankare nga “NBG”-ja, për periudhën nga data 31.07.2013 deri më datë 15.05.2014, nga Agjencia e Sigurimeve Shëndetësore, në shumën **592.900 lekë**.
- Nxjerrje llogari bankare nga “NBG”, për periudhën 12.10.2010 - 24.11.2010, nga Agjencia e Sigurimeve Shëndetësore, në shumën **218.394 lekë**.
- Njoftime depozitë e stafit, nga Banka Amerikane e Shqipërisë, më datë 01.12.2009, të shumës **15.572 USD**.

Hetimi i Komisionit:

32.2 Verifikimi i të ardhurave është trajtuar në të gjitha transaksionet e mësipërme, mbështetur në të dhënat e konfirmuara nga sigurimet shoqërore, nga “Intesa Sanpaolo Bank” dhe nga “NBG”.

- ✓ Personi i lidhur ka të ardhurat në vlerën totale prej rreth 19.730.000 lekësh.

33. DETYRIME FINANCIARE:

- Detyrim i pashlyer nga kontrata për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 74.95 m² ende i paregjistruar në qytetin e Sarandës, në vlerën 6.000 euro.

33.1 Personi i lidhur vë në dispozicion:

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.03.2009, midis shoqërisë “****” sh.p.k., me përfaqësues të shoqërisë “****” sh.p.k, z. N. Ç dhe pala blerëse E. G (Dh.) për porositje apartamenti, me sip. total 74.95 m², me vlerë 38.500 euro. Sipas kësaj deklarate rezulton se është likuiduar vlera 28.500 euro dhe detyrimi i mbetur është 10.000 euro.

Hetimi i Komisionit:

33.2 Mbi këtë detyrim, Komisioni, ka bërë trajtimin në pikën “3” të vtë pasurisë së zotëruar 100 % nga personi i lidhur, konkretisht për porositjen e apartamentit në qytetin e Sarandës dhe raporti me shoqërinë “****” sh.p.k., dhe bashkëshortët N.Ç. dhe L.(E.)Ç. Detyrimi i mbetur pa likuiduar në lidhje me këtë pasuri rezulton të jetë deklaruar në mënyrë të qartë dhe me saktësi.

✓ Detyrimi i mbetur është në vlerën 6.000 euro.

34. Vlerësimi përfundimtar i pasurive

34.1 Nga analiza financiare ndër vite rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mjete monetare të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera.

34.2 Nga pasaktësitë e konstatuara nuk lindin dyshime të arsyeshme për veprime që cenojnë figurën e gjyqtarit.

34.3 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni, çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut tek drejtësia.

34.4 Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Enton Dhimitri, ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

35. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/206. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën, nr. *** prot., datë 27.10.2017, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Enton Dhimitri.

36. Komisioni ka marrë një denoncim nga shtetasi P. M, më datë 27.8.2018, ku deklarohet se kunati i subjektit të rivlerësimit, shtetasi L. G., është dënuar në Greqi me 20 vite burg sepse është kapur me 20 kg lëndë narkotike të tipit kokainë.

37. Komisioni kreu një hetim të thelluar, për të verifikuar pretendimet e përmendura në denoncim, duke kërkuar informacion nga organet shtetërore dhe subjektet e tjera jopublike në zbatim të neneve 34 -38 të ligjit nr. 84/2016.

38. Bazuar në informacionet e marra nga organet kompetente rezulton se dalja e fundit e shtetasit L. G. nga territori i Republikës së Shqipërisë është regjistruar në pikën e kalimit kufitar Kakavijë, më datë 07.06.2016 dhe që nga kjo datë nuk rezulton asnjë hyrje në vendin tonë (bazuar në të dhënat e sistemit *TIMS*).

39. Më datë 19.10.2018, vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka paraqitur një gjetje në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 10 të ligjit nr. 84/2016. Gjetja konfirmon se:

“Në një përpjekje për të verifikuar këtë informacion, ONM-ja kërkoi informacione nga autoritetet greke përmes kanaleve të ndryshme ligjzbatuese në vend. Nga këto hetime, dy burime të pavarura konfirmuan se (shtetasi) L. G., është arrestuar për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike në vitin 2016. bazuar në nenin 49, pika 10, të ligjit nr. 84/2016, është që L. G., është "person i përfshirë në krimin e organizuar" siç përcaktohet në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016”.

40. Pas kërkesës së Komisionit, më datë 25.10.2018, DSIK-ja raportoi se L. G. konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të ligjit të rivlerësimit kalimtar, por mes L. G., dhe subjektit të rivlerësimit nuk rezultonte asnjë lidhje për të ndryshuar qëndrimin fillestar të organit ndihmës mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së tij.

41. Në vijim, pas informacionit të mëtejshëm, të ardhur nga autoritetet verifikuese, më datë 01.11.2018, përcillet raporti vijues për Kontrollin e Figurës së subjektit të rivlerësimit, pjesërisht i deklasifikuar, në të cilin thuhet se, nga informacionet e marra prej institucioneve të verifikimit rezulton se *“Për vetë shtetasin L. G., disponohen të dhëna, ku ngrihen dyshime se është përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar,.... në bashkëpunim me persona të tjerë...”* Ky shtetas është arrestuar, më datë 25.06.2016, i dyshuar për konsumimin e veprës penale *“të shkeljes së ligjit mbi narkotikët”* në shtetin Grek.

42. Në përfundim duke arsyetuar në mënyrë shteruese, Grupi i Punës pranë DSIK-së, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar - në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Enton J. Dhimitri.

43. Sipas shtojcës 3, “Deklarata e Kontrollit të Figurës”, pjesa 5- Të dhëna për sigurinë, pika “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “A keni dijeni se një nga anëtarët e familjes suaj është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?” – me termin “anëtar familjeje”, do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë, personi i lidhur me detyrime birësimi ose që bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët.

44. Bazuar në sa më sipër Komisioni ngriti dyshime për saktësinë e deklaramit në deklaratën për kontrollin e figurës.

45. Pika 3 e nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 parashikon: “*Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve, por gjithashtu çdo rrethanë lehtësuese që lidhet me çdo gjetje. Çdo vlerësim i kontrollit të figurës që nuk përmban rrethanat që merren parasysh në konstatim si dhe rrethanat lehtësuese konsiderohet i paplotë*”.

46. Me qëllim qartësimin kësaj gjetjeje sipas kërkesave ligjore të përcaktuara më lart, Komisioni kërkoi sqarime nga subjekti i rivlerësimit me pyetjet e drejtuara ndaj tij.

47. Për shkak se rekordet kriminale për shtetasin L. G., nuk ishin deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni gjithashtu kërkoi shpjegime prej tij lidhur me marrëdhëniet, kontaktet dhe afrimitetin ndërmjet tij dhe këtij shtetasi (kunati i subjektit), si dhe mbi situatën aktuale.

48. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte pasur kontakte me shtetasin L. G., në tre vitet e fundit. Subjekti i rivlerësimit mohoi të ketë pasur marrëdhënie afrimiteti me kunatin e tij L.G., për shkak të angazhimit të tij familjar (mbi përkujdesjen e tij për shëndetin e bashkëshortes, të babait dhe të dy fëmijëve të mitur), si dhe për shkak të përbaljes me ngarkesë të madhe në punë.

49. Trupi gjykues, ngriti dyshimin mbi mungesën e kontakteve, apo të dijenisë së tij mbi aktivitetet e kunatit, apo edhe të mungesës fizike të këtij, kur ky i fundit është bashkëpronar së bashku me motrën dhe nënën e tij në banesën ku jeton dhe subjekti i rivlerësimit. Dyshime u ngritën mbi pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai nuk kishte dijeni për vendndodhjen dhe arrestimin e kunatit L. G., kur ka plotësuar deklaratën “Vetting” të vitit 2017. Për këtë arsye subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës.

50. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar një seri argumentesh nga të cilat rezultoi se: nuk ka pasur dijeni mbi faktin e dënimit të kunatit të tij; nuk kishte mundësi që një fakt të tillë ta mësonte drejtpërdrejt nga verifikimi në Regjistrin e Gjëndjes Gjyqësore; nuk mund të mendonte mbi eventualitetin e këtij fakti për shkak të angazhimeve me problemet e shëndetit të babait dhe të bashkëshortes si dhe kujdesin për fëmijët e mitur, përveç ngarkesës së përditshme e të madhe në punë. Po kështu, fakti në fjalë i është mbajtur i fshehtë edhe nga familjarët e tjerë të bashkëshortes, deri në momentin e bërjes me dije nga Komisioni.

51. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, shpjegoi gjatë seancës dëgjimore dhe argumentoi mbi tronditjen e raporteve të tij me shtetasin L. G., që prej vitit 2010, për shkak të mënyrës së reagimit të tij pas lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes në favor të ish-bashkëshortes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe lënies në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, ngjarje që shkaktoi pakënaqësi tek kunati për shkak të mos mbështetjes nga ana e subjektit. Një tjetër shkak i tronditjes së raportit në fjalë, lidhet me mënyrën e jetesës jo të rregullt të kunatit. Si moment me tronditjen më të fortë të këtij raporti, subjekti i rivlerësimit referon fundin e vitit 2013 dhe fillimin e vitit 2014, kur shtetasi L. G., përfshihet në një konflikt fizik me ish-bashkëshorten dhe për shkak se subjekti i rivlerësimit u distanca nga ky veprim, kunati L. G., kundërreagon dhe e fyen në prezencë të kunatit tjetër G. G., dhe, që prej kësaj periudhe shkaput çdo komunikim dhe interesim tjetër, përveç informimit mbi gjendjen shëndetësore. Nga subjekti i rivlerësimit mohohet fakti i banimit brenda të njëjtës banesë me shtetasin L. G., për të cilin shpjegon se, në pjesën më të madhe të kohës ka qëndruar në Greqi, ndërsa në Gjirokastrë, ai ka një banesë tjetër në pronësi të tij.

52. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka shoqëruar shpjegimet me vërtetim të gjendjes gjyqësore të shtetasit L. G. (ku figuron i padënuar) si dhe vërtetim pronësie të një shtëpie në emër të tij; me deklaratimet noteriale të: bashkëshortes, të kunatit G. G., dhe të vjerrës A. G., të cilët deklarojnë se fakti i është mbajtur i fshehur si ndaj subjektit të rivlerësimit, ashtu edhe ndaj bashkëshortes, për shkak se nuk donin të rëndonin situatën psikologjike të tyre, duke marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore të saj dhe të babait të tij që mund të rëndoheshin edhe më tej. Këto vërtetime dhe deklarime janë administruar në dosje.

53. Në analizë të të gjitha përgjigjeve të institucioneve ligjzbatuese, tek të cilat Komisioni kërkoi të dhëna mbi situatën shtetasit L. G., si dhe raportet e mundshme të tij me subjektin e rivlerësimit, Komisioni, shqyrtoi edhe mundësitë e pasjes dijeni të faktit të ndalimit dhe të dënimit të tij nga ky i fundit. Në kuadër të kësaj analize, u morën në konsideratë materiale që provojnë përballjen e shtetasit L. G., me organet e drejtësisë për shkak të konfliktit të tij me ish-bashkëshorten dhe me fëmijët, materiale që provojnë lëvizjet e tij në pikën e kalimit kufitar Kakavijë (hyrje-dalje, mjet udhëtimi), krahasuar me të dhënat e kohës që i përkasin subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes, vjehrrës dhe kunatit tjetër shtetasit G. G.

54. Nga verifikimi i dokumentacionit, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, nga Drejtoria Vendore e Policisë së Prefekturës Gjirokastrë dhe nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nuk rezultuan rrethana me natyrë privilegjuese ndaj shtetasit L. G., në raport me ish-bashkëshorten dhe fëmijët e tij, çka në një hipotezë të kundërt mund të nënkuptonte mundësinë e përfshirjes së subjektit të rivlerësimit në ecurinë procedurave në mënyrë jozyrtare për favorizimin e shtetasit L. G.. Institucionet kanë pasqyruar me saktësi faktet dhe rrethanat e konfliktit, si dhe kanë zbatuar drejt ligjin në rastin konkret. Qëndrimet e institucioneve nuk rezultojnë që të jenë ankimuar nga personat që kanë pretenduar se janë dëmtuar nga veprimet e shtetasit L. G., (përjashtojnë ankimin që shtetasi L. G., ka ushtruar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë kundër vendimit Gjykatës së Shkallës së Parë që la lëshuar urdher të menjëhershëm mbrojtjeje). Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë udhëtim apo kalim ndërkuftar në 5 vitet e fundit me

këtë shtetas, pas problematikave të shfaqura prej tij. Nga sa më sipër, deklarimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë raporti dhe afrimiteti me kunatin rezulton i besueshëm.

55. Gjithashtu, në vlerësim të përgjigjeve nga institucionet në fjalë, se pavarësisht faktit të përfshirjes së shtetasit L. G., në veprimtari kriminale, përjashtohet çdo lidhje mes tij dhe subjektit të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë mungesën e komunikimeve të drejtpërdrejta mes subjektit të rivlerësimi apo bashkëshortes me shtetasin L. G. (referuar materialeve të shoqërive të telekomunikacionit që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë) si dhe në konsideratë të periudhës së ndalimit të shtetasit L. G., të dënimit të tij, të mospasqyrimit të këtij fakti në gjendjen e tij gjyqësore në Shqipëri, deklarimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë dijenie mbi ngjarjet në lidhje me kunatin është i besueshëm.

56. Në të njëjtën linjë arsyetimi dhe konkluzioni rezulton që të ketë arritur edhe z. John Leonardo, vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili, me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2018, i përshkruan në mënyrë sintetike rrethanat e mësipërme dhe i parashtron si të detyrueshme për t'u marrë në konsideratë në përputhje me pikën 3, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016. Për këtë ai ka depozituar pranë komisionit një "Gjetje", në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 10, të ligjit 84/2016 ku konkludohet se: *"Në mënyrë të besueshme, subjekti i rivlerësimit nuk është në dijeni të faktit se kunati i tij është i përfshirë në krimin e organizuar"*.

57. Si përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni të rekordeve kriminale të kunatit të tij, shtetasit L. G., dhe nuk ka pasur mundësi për të deklaruar faktin në Deklaratën e Kontrollit të Figurës. Nga sa më sipër Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Enton Dhimitri është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës për sa i përket vlerësimit të kontrollit të figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

58. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin:

58.1 Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së, sipas shkresës nr. *** prot., datë 09.02.2018;

58.2 Vlerësimit të denoncimeve dhe vendimet gjyqësore të paraqitura në ankesat e subjekteve denoncuese;

58.3 Kriteve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (neni 71 e vijues i tij).

59. Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektorati i KLD-së është bazuar në:

59.1 Formularin e vetëdeklarimit, në 3 dokumente ligjore të përzgjedhur nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjerë që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit.

59.1.2 Pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

59.1.3 Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

59.2 Nga analiza e Inspektoratit të KLD-së, mbi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

59.2.1 Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, është nënshkruar në çdo fletë dhe është i rregullt nga pikëpamja formale. Subjekti nuk ka deklaruar adresë zyrtare.

59.2.2 Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Subjekti ka deklaruar se në periudhën shtator 2004 - tetor 2005, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin; në periudhën tetor 2005 - mars 2014, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nga marsi 2014 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

59.2.3 Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti ka deklaruar se në 3 vitet e fundit ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, nuk ka pasur ndarje në trupa gjyqësore të caktuara apo në dhoma të veçanta sipas fushave (civile, penale, administrative apo familjare). Atij i janë caktuar për shqyrtim gjithsej 820 çështje gjyqësore në periudhat: 01.01.2014 - 13.03.2014 (si gjyqtar i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë) dhe 14.03.2014- 31.12.2016 (si relator në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë). Për këtë periudhë subjekti ka përfunduar 762 çështje; çështje të mbartura: 29.

59.2.4 Trajnimet në 3 vitet e fundit

Subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës së rivlerësimit ka qenë ekspert në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në 15 aktivitete trajnuese.

59.2.5 Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 3 dokumente ligjorë, të llojit vendim gjyqësor. Një prej këtyre vendimeve ka qenë i vitit 2015 dhe 2 vendimet e tjera të vitit 2014.

60. Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

60.1 Subjekti i rivlerësimit ka të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së, për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ai ka ushtruar në këtë periudhë.

60.2 Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 7 ankesa: 2 ankesa në vitin 2014, një ankesë në vitin 2015 dhe një ankesë në vitin 2016, të cilat janë arkivuar nga ana e KLD-së, për shkak se ishin të përsëritura dhe për to ishte dhënë më parë përgjigje si dhe për shkak se pretendimi në ankesë lidhej me zgjidhjen e themelit të çështjes, pra me ushtrimin e mjeteve të ankimeve gjyqësore.

60.3 Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, i bazuar në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë:

61. Lidhur me aftësitë profesionale

61.1 Njohuritë ligjore.

61.1.1 Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit procedural dhe substancial. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Identifikon rastet kur hetimi gjyqësor nuk është kryer i plotë në shkallën e parë dhe vendos kryerjen e hetimit të pjesshëm në gjykimin në apel (dokumenti 2). Identifikon rastet kur ligji material është interpretuar gabim nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe jep kuptimin e saktë të përmbajtjes së normës konkrete (dokumenti 1 dhe 2). Identifikon rastin e papërdorshmërisë së një prove të marrë në mënyrë të kundërligjshme në procesin e hetimit penal (dokumenti 3). Pasqyron në vendime parime juridike si: gjëja e gjykuar (dokumenti 3), apo barra e provës në procesin penal (dokumenti 3). Pasqyron referenca nga praktika unifikuuese e Gjykatës së Lartë (dokumenti 2 dhe dosja 2) dhe zbaton detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë në rigjykim (dosjet 3 dhe 4). Zbaton drejtpërdrejt dispozitat Kushtetuese dhe të KEDNJ-së atëherë kur nga këto merr zgjidhje çështja konkrete (dokumenti 2). I kushton rëndësi respektimit ose të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta, por nuk evidentohen raste të prishjes së vendimeve të shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

61.1.2. Nga 3 dokumentet e zgjedhura nga subjekti dhe 5 dosjet e shortuara, konstatohet se subjekti zotëron mjaft mirë të drejtën civile - detyrimet, shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, pronësinë, të drejtën familjare mbi aspektet e mbrojtjes nga dhuna në familje. Gjithashtu, subjekti zotëron të drejtën e procedurës penale si dhe të drejtën penale, sikurse rezulton nga procedura e shqyrtimit të vendimeve të prokurorit gjatë hetimit paraprak (dosja 1) dhe për masat e sigurimit (dosja 2). Ndër 3 dokumentet ligjore të zgjedhura nga subjekti dhe 5 dosjet e shortuara, është ankimua në Gjykatën e Lartë vetëm një vendim (dosja 4) dhe kjo e fundit nuk është shprehur ende.

61.2 Arsytimi ligjor

Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara janë të qarta dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është e standardizuar dhe arsyetimi është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e palëve. Në vendim ekziston lidhja e fakteve të mosmarrëveshjes dhe konkluzioneve që ka arritur subjekti. Gjyqtari i kushton vëmendje edhe mënyrës së zgjidhjes nga gjykata më e ulët, duke argumentuar si në rastin kur ajo është e drejtë, ashtu edhe në rastin kur ajo është e gabuar. I kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme (dosjet 3 dhe 4).

62. Lidhur me aftësinë organizative

62.1 Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

62.1.1 Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në dy gjykata: deri më datë 13.03.2014, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, dhe nga kjo datë e në vijim, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

62.1.2 Subjektit të rivlerësimit për periudhën, në 3 vitet e fundit, ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim 820 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar 762 me një rendiment prej 96,4 %.

62.1.3 Sipas të dhënave statistikore të Gjykatës së Apelit Gjirokastër konstatohet se për periudhën e rivlerësimit subjekti ka përfunduar gjithsej 654 çështje gjyqësore nga të cilat 257 çështje penale dhe 380 civile të përgjithshme dhe 17 çështje civile familjare. Standardet minimale për gjyqtarët relatorë në gjykatat e apelit (sipas dhomave ose seksioneve civile/penale) janë: 150 gjykime penale dhe 200 gjykime civile. Subjekti i rivlerësimit ka qenë në gjykatë që nuk ishte e ndër ne dhoma/seksione të gjykimeve civile ose penale. Për këtë arsye, është çmuar që standardi me 200 çështje në vit është më i përafërt me atë të parashikuar në pikës 3 gërmat “h” dhe “i” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, ngarkesa për 3 vite nënkupton jo më pak se 600 çështje civile dhe penale. Në konsideratë të kësaj llogaritjeje, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka përballuar një ngarkesë mbi atë standarde.

62.1.4 Nga analiza e 5 dosjeve kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në intervale kohore nga 6 ditë deri në 11 muaj e 26 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të madhe ka qenë çështje civile me kompleksitet në shumë aspekte, por që është zgjidhur me vendim përfundimtar.

62.1.5 Në analizën e 3 dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë 2 muaj 9 ditë (dokumenti 1), 5 muaj (dokumenti 2) 3 muaj 3 ditë (dokumenti 3). Në të tre këto raste është respektuar afati standard i gjykimit.

62.1.6 Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit, duke çmuar se data e arsyetimit është data e dorëzimit të dosjes në kryesekretarinë e gjykatës (si e vetmja e dhënë objektive), konstatohet se subjekti i ka kushtuar rëndësi të madhe arsyetimit të vendimeve në kohën e duhur, duke

respektuar në çdo rast afatet ligjore. Gjithashtu, konstatohet se subjekti respekton kohën në gjykim, si aspekt tjetër i procesit të rregullt ligjor.

62.2 Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, ku përgjithësisht seancat kanë qenë produktive. Në 5 dosjet e vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (dosje 1 dhe 2), me 11 seanca (dosje 3), me 6 (seanca (dosje 4) dhe me 2 seanca (dosje 5). Nga 22 seanca të vëzhguara, 9 seanca kanë qenë produktive. Për 13 seancat e shtyra, pengesë kanë qenë faktorë të cilët nuk lidhen me subjektin e rivlerësimit. Çdo seancë është zhvilluar në sallë dhe me regjistrim audio, tipar i respektimit të solemnitetit në seancës gjyqësore. Gjithashtu, distancat kohore mes seancave janë të arsyeshme, duke marrë në konsideratë edhe shkaku e shtyrjes. Konstatohet se zhvillon procedurat në mënyrë korrekte gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, ndjek hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve prezentë dhe shkaqet e mungesës sipas rastit, komunikimin e të drejtave procedurale tek palët prezentë, prezantimin e gjykatës etj, duke orientuar drejt debatin dhe hetimin gjyqësor.

62.3 Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short janë konstatuar se përgjithësisht kanë qenë të rregullta dhe të plota, me një mangësi: nuk ka një akt formal të gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë gjyqësore, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes. Për veprimet e kryera është mbajtur procesverbal gjyqësor në përputhje me kërkesat e ligjit.

63. Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

63.1 Etika në punë

Në periudhën shtator 2004 - tetor 2005, subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin; në periudhën tetor 2005 - mars 2014, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; nga marsi 2014 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Në regjistrin e ankesave pranë KLD-së nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të subjektit. Ankesa të kësaj natyre nuk rezultuan as nga denoncimet e drejtpërdrejta pranë Komisionit.

63.2 Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

63.3 Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo pakicave dhe nuk

është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese, apo elementëve të tjerë që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në 1 rast është konstatuar se ai e ka vlerësuar moshën e mitur të palës paditëse dhe ka zbatuar korrekt rregullat e përfaqësimit për të në gjykim (dosja 4). Nuk është konstatuar që subjekti të këtë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave në gjykim.

64 Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

64.1 Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet e vëzhguara dhe në 3 dokumentet e sjella, në procesverbalin gjyqësor nuk ka dhëna për mënyrën direkt të komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar pa pjesëmarrjen e palëve dhe gjuha e përdorur në akte është normale.

64.2 Aftësia për të bashkëpunuar

Nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, bashkëpunimi me administratën dhe anëtarët e trupit gjykues, çmohet të ketë qenë në nivelin e duhur, pasi është konstatuar se arsyetimi i vendimit dhe dorëzimi i dosjes gjyqësore në sekretari është bërë në çdo rast pa vonesa, çka dëshmon aftësi të tij të bashkëpunimit me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore.

64.3 Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit është angazhuar thellësisht në aktivitete profesionale. Ai i ka kushtuar rëndësi formimit akademik dhe programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në të cilën ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 15 seminare të organizuara prej saj.

65. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në ankesat e subjekteve pranë KLD-së, si më poshtë:

65.1 Subjekti i rivlerësimit ka të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së, për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ai ka ushtruar në këtë periudhë. KLD-ja i ka përcjellë materialet e shqyrtuara prej saj me shkresat nr. *** prot., datë 14.02.2018 (15 ankesa) dhe nr. *** prot., datë 16.03.2018 (2 ankesa).

65.2 *KLD-ja ka marrë në shqyrtim të gjitha ankesat e listuara në raportin e saj dhe ka arritur në përfundimin se faktet dhe shkaqet për të cilat janë bërë këto ankesa lidhen me mënyrën e përfundimit të themelit të çështjes gjyqësore dhe nuk ka indice për të provuar pretendimin e tyre, për gjetje thelbësore që do ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.*

65.3 Për sa më sipër, nuk ka indice për të provuar pretendimin e tij, për gjetje thelbësore që do ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

66. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në denoncimet e subjekteve, si më poshtë:

66.1 Komisioni, administroi dhe mori në shqyrtim 7 denoncime nga publiku. Denoncimet hidhnin dyshime mbi; procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë procesit gjyqësor, vendimmarrjen, korrupsionin e mundshëm, konfliktin e interesit, etj.

1. denoncimin e shtetasit V. Ç., nr. *** prot., datë 08.02.2018;
2. denoncimin e shtetasit E. R., nr. *** prot., datë 05.04.2018;
3. denoncimin e shtetasit M .A., nr. *** prot., datë 24.07.2018;
4. denoncimin e shtetasve B. Ç. dhe V. Ç., nr. *** prot., datë 08.08.2018;
5. denoncimin e shtetasit Sh. H., nr. *** prot., datë 19.09.2018;
6. denoncimin e shtetasit R. I., nr. *** prot., datë 31.10.2018;
7. denoncimin e shtetasit T. Q., nr. *** prot., datë 02.11.2018.

66.2 Për sa më sipër, Komisioni, konstatoi se nuk ka indice për të provuar pretendimet e denoncuar, për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në të shumtën e rasteve, faktet dhe shkaqet për të cilat bëhen ankesat lidhen me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit gjyqësor, të cilat kontrollohen nga gjykata në nivel më të lartë sipas procedurës dhe këto nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

66.3 Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, z. Enton Dhimitri, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë duke respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, ka qenë eficient, efektiv në masë të pranueshme dhe Komisioni e ka vlerësuar si “*të aftë*” në detyrën e gjyqtarit.

D. KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes dhe vëzhguesit ndërkombëtar, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59 pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Enton Dhimitri.

2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 22.11.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Xhensila PINE
Anëtar

Pamela QIRKO
Relatore

ANISA DUKA
Sekretare gjyqësore